

**POLICIMI NË
KOMUNITET
NË SHQIPËRI
2007-2015**



**Vlerësim i strategjisë së policimit në
komunitet dhe bashkëpunimin
mes Policisë së Shtetit dhe
Institucioneve të Qeverisjes Vendore**

Tiranë 2015

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2.	HYRJE	6
3.	METODOLOGJIA	8
4.	FILOZOFIA E POLICIMIT NË KOMUNITET	11
4.1	Zhvillimi i policimit në komunitet	11
4.2	Sfidat dhe implikimet e policimit në komunitet	13
5.	POLICIMI NË KOMUNITET NË SHQIPËRI	15
5.1	Përqasja normative për zbatimin e policimit në komunitet	15
5.1.1	Ligji dhe Strategjia e re e Policisë së Shtetit	21
5.2	Miratimi i rregullt i SVPQ	23
5.2.1	Sasia	24
5.2.2	Përmbajtja	25
5.3	Data dhe Firmat	25
5.3.1	Firma e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë	25
5.3.2	Firma e Drejtorit të të Policisë së Qarkut	26
5.3.3	Data e Miratimit të SVPQ	27
5.3.4	Detyrimi për t'ia paraqitur strategjinë IQV përpara miratimit nga DPP	29
5.3.5	Raportimi i Veprave Penale (C pika 1)	30
5.3.6	Angazhimi për të bashkëpunuar me komunitetin (C, pika 3)	31
5.3.7	Trajtimi i problemeve të komunitetit (C, pika 2)	32
5.3.8	Rekomandime për uljen e veprave penale (C, pika 4)	35
5.4	Përmbledhja e gjetjeve në lidhje me përputhshmërinë në rang kombëtar dhe efektiviteti i zbatimit të SVPQ	37
5.4.1	Ndikimi	39
5.4.2	Bashkëpunimi me IQV	42
5.4.3	Praktika e bashkëpunimit midis PSH dhe IQV	43
5.5	Faktorët që lehtësojnë dhe vështirësojnë Zbatimin e SVPQ dhe Bashkëpunimin midis PSH dhe IQV	47
6.	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	51
7.	REFERENCAT	54



DCAF
Working for
Security and
Democracy



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Autor: Ola Cami

Redaktoi: Arjan Dyrmishi

Sqarim: Ky studim u realizua me mbështetjen e Qendrës së Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF). Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë studim është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të DCAF.

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Policia e Shtetit (PSH) ka zbatuar policimin në komunitet në nëntë vitet e fundit me synim krijimin e partneritetit të komunitetit me aktorë të tjerë në nivel vendor. Qëllimi kryesor ka qenë krijimi i një mjedisi më të sigurt përmes vendosjes së partneriteteve dhe strukturave të qëndrueshme në komunitet.ⁱ

Si instrument për të nxitur bashkëpunimin mes Policisë së Shtetit dhe institucioneve të qeverisjes vendore, aktorëve dhe palëve të interesuara, Ligji për Policinë e Shtetit detyron hartimin dhe miratimin e strategjive vjetore rajonale të policisë. Megjithatë, edhe pse këto strategji janë hartuar rregullisht çdo vit nga drejtoritë e policisë në rrethe, këto dokumente nuk janë marrë parasysh dhe, si pasojë, nuk janë përdorur si instrumente për të nxitur bashkëpunimin me aktorët vendorë.

Strategjitë kanë probleme me përputhshmërinë ligjor veçanërisht në lidhje me datën e miratimit të tyre, trajtimit të nevojave të komunitetit si dhe konsultimit paraprak me institucionet e qeverisjes vendore (IQV) përpara dërgimit për miratim nga grupi i politikave. Strategjitë janë shumë të ngjashme në formë dhe përmbajtje dhe nuk marrin parasysh kontekstin specifik të qarkut dhe strukturën e komunitetit. Pavarësisht se PSH dhe IQV kanë pasur ndërveprim të vazhdueshëm, nuk ka rezultuar në angazhimin e IQV në hartimin dhe zbatimin e Strategjitë Vjetore të Policimit në Qark (SVPQ) dhe për rrjedhojë në hartimin e strategjive efektive dhe të zbatueshme. Si e tillë, ka qenë e vështirë që këto strategji të kenë pasur një ndikim pozitiv në krijimin e strukturave komunitare dhe marrëdhënieve të konsoliduara me

IQV, siç përcaktohet në Strategjinë e Policisë 2007-2013 si dhe në rënien e nivelit të kriminalitetit dhe në përmirësimin e përgjithshëm të sigurisë së komuniteteve.

Ky dokument rekomandon që PSH duhet të bëjë një vlerësim të plotë të zbatimit të policimit në komunitet dhe të rishikojë objektivat dhe mjetet e saj, duke marrë parasysh sfidat e këtij procesi në kontekstin institucional dhe kulturor të vendit.

2. HYRJE

Që me miratimin e modelit të policimit në komunitet rreth një dekade më parë, një nga prioritetet kryesor ka qenë realizimi i konsultimeve dhe krijimi i bashkëpunimit efikas mes Policisë së Shtetit dhe institucioneve të qeverisjes vendore (IQV).

Me qëllim zbatimin e modelit të policimit në komunitet (PK), Ligji për PSH përcakton detyrimin e (12) drejtorive të policisë në qarqe për të hartuar strategji vjetore të policimit në qark, në konsultime të përbashkëta me IQV-të dhe grupet e interesit. Përveç kësaj, ligji përcakton se në strategjinë vjetore duhet të identifikohen problemet e sigurisë që preokupojnë komunitetin vendor, të propozohen rekomandime për zgjidhjen e këtyre problemeve, si dhe të bëhet një vlerësim se si janë zgjidhur problemet e identifikuara nga komuniteti në strategjinë e viteve të mëparshme të policimit. Ligji përcakton që drejtoritë rajonale të policisë duhet të paraqesin ë dokumentin e strategjisë tek IQV-të për miratim përfundimtar përpara miratimit të tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.ⁱⁱ

Në të njëjtën linjë me ligjin, Strategjia PSH 2007-2013 përcakton si prioritet zbatimin e PK dhe konsolidimin e partneritetit me komunitetet nëpërmjet krijimit të strukturave të përbashkëta, krijimit të një kulture të re menaxhimi, përmirësimit të infrastrukturës dhe të imazhit të policisë.ⁱⁱⁱ

Tetë vjet nga miratimi i ligjit dhe strategjisë, si dhe me miratimin e strategjisë së re të policisë (2015-2020), nuk është bërë asnjë vlerësim i pavarur për punën e Policisë së Shtetit dhe IQV-ve në përpjekje për të krijuar një bashkëpunim të konsoliduar dhe të ndërvarur: si janë trajtuar problemet dhe

shqetësimet e komuniteteve vendore në mënyrë institucionale në sistemin e policimit, a kanë qenë efektive mekanizmat e përzgjedhur në forcimin e këtij bashkëpunimi dhe deri në ç'masë është krijuar ky bashkëpunim si dhe kush kanë qenë problemet kryesore të cilat e kanë frenuar procesin.

Përkundrejt këtij konteksti, ky studim synon të kontribuojë në përpjekjet për të vlerësuar zbatimin e PK. Studimi përqendrohet si në vlerësimin e proceseve të ndërveprimit të Policisë së Shtetit dhe IQV-ve ashtu edhe te rezultati i këtij bashkëveprimi, d.m.th., strategjitë vjetore. Si proceset ashtu edhe rezultatet shqyrtohen në aspektin sasior dhe cilësor. Pra, proceset shqyrtohen për nga dendësia e ndërveprimeve ndërmjet PSH dhe IQV-ve, ndërsa strategjitë shqyrtohen në aspektin e rregullsisë dhe nivelit të kontributit të tyre në përmirësimin e sigurisë së komuniteteve dhe për rritjen e nivelit të besimit reciprok dhe përgjegjshmërisë së Policisë së Shtetit dhe IQV-ve.

Në seksionin e mëposhtëm jepet një përshkrim i metodologjisë dhe i filozofisë së policimit në komunitet së bashku me sfidat e zbatimit të tij në kontekste të ndryshme. Më tej studimi vijon me analizën e zbatimit të PK në Shqipëri, duke u fokusuar në zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik të PSH. Studimi mbyllet me një paraqitje të konkluzioneve dhe rekomandimeve për PSH dhe IQV.

3. METODOLOGJIA

Për të realizuar qëllimet e përcaktuara më sipër ky studim u bazua në analizën e një sërë të dhënash sasiore dhe cilësore. Fokusi i analizës është evidentimi i rregullsisë së miratimit dhe zbatimit të strategjive dhe institucionalizimit të marrëdhënieve mes PSH dhe komuniteteve vendore.

Si hap të parë, studimi u fokusua në shqyrtimin edhe analizën e kuadrit ligjor dhe strategjik që përcakton aktorët dhe procedurat për miratimin dhe zbatimin e modelit të policimit në komunitet. Më tej, u analizuan 84 strategji vjetore të miratuara nga 12 drejtoritë rajonale të policisë në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2014.^{iv} 77 nga këto dokumente janë mundësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe disa Drejtori të Policisë në nivel qarku. Dokumentet që nuk janë analizuar i përkasin 7 qarqeve në vitin 2013.

Strategjitë janë analizuar veçmas për të parë përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit si dhe për të gjetur evidenca të bashkëpunimit me IQV. Më pas gjetjet janë përmbledhur duke përdorur një analizë ndër-rajonale si dhe analizë ndër-kohore nga viti 2007 deri në vitin 2014 për të vëzhguar prirjet e përgjithshme.

Analiza dhe vlerësimi i procesit të ndërveprimit dhe bashkëpunimit mes PSH dhe IQV-ve, si dhe vlerësimi i ndikimit të strategjive në krijimin e bashkëpunimit me komunitetin vendor dhe në uljen e veprave penale u realizua në 4 qarqe të përzgjedhura. Këto të fundit u përzgjedhën me qëllim që të sigurohemi se ata përfaqësojnë IQV që qeverisen nga parti të ndryshme politike, që kanë shpërndarje të

ndryshme gjeografike dhe kanë probleme të ndryshme të sigurisë, si më poshtë vijon:

Tabela 1. Të dhënat e përzgjedhjes sipas qarqeve

Kriteri/Drejtoria	Durrës	Gjirokastrë	Kukës	Vlorë
Popullsia	E lartë	E ulët	E ulët	E lartë
Dendësia e popullsisë	E lartë	E ulët	E ulët	E ulët
Sipërfaqja gjeografike	E vogël	E madhe	E vogël	E madhe
Klima	Bregdetare	Kontinentale	Kontinentale	Bregdetare
Pozicioni gjeografik	Veri/perëndim	Jug/lindje	Veri/lindje	Jug/perëndim
Rritja e popullsisë	Më e larta*)	Më e ulëta		
Raporti popullsi/polici	E lartë	E ulët	E ulët	E lartë

*) E dyta pas Tiranës

Vlerësimi i ndikimit të strategjive në krijimin e bashkëpunimit është matur nëpërmjet të dhënave të grumbulluara nga SVPQ rreth “nevojës për bashkëpunim” që PSH ka në zbatimin e kësaj strategjie. Më konkretisht është vëzhguar nëse përfshirja e IQV në planet e veprimtimit është intensifikuar vit pas viti.

Në të njëjtën kohë, duke qenë se PSH e konsideron prioritarë uljen e numrit të veprave penale dhe rritjen e zbulueshmërisë si në dokumentin e Strategjisë Kombëtare 2007-2013, po ashtu edhe në vetë Strategjitë Vjetore të Policimit në Qark (SVPQ), janë grumbulluar të dhëna rreth këtyre shifrave nga përmbajtja e SVPQ dhe janë analizuar në këtë interval kohor. Përveç analizimit të të dhënave që gjenden në SVPQ, janë

realizuar 40 intervista gjysmë të strukturuar telefonike me kryetarët dhe ish-kryetarët e bashkive dhe komunave.^v

Në të njëjtën kohë, iu dërguan letra kryetarëve të bashkive, prefektëve dhe drejtorëve të policisë të 4 qarqeve të zgjedhura,^{vi} ku iu kërkohet të na jepnin dokumentet e strategjive nga viti 2007 deri në vitin 2014.^{vii} Qëllimi i një kërkese të tillë është jo vetëm që të merrnim këto dokumente, por në të njëjtën kohë të shihnim nëse aktorët ishin të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për të miratuar strategjitë çdo vit para miratimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Duke qenë se shkalla e bashkëpunimit mes aktorëve nuk përcaktohet në ligj, në fokus të intervistave ishte analizimi i kanaleve të komunikimit, shpeshësia e komunikimit dhe mënyra e bashkëpunimit. Po ashtu, qëllimi i intervistave ishte të evidentohet ecuria në kohë dhe fakti nëse proceset janë brendësuar tashmë nga të dy palët. Për të konfirmuar konstatimet, u realizuan intervista me tre oficerë policie (POL01, POL02, POL03).

Duke pasur parasysh se Ligji për Policinë e Shtetit dhe strategjia e re u miratuan në vitin 2014, ky studim i merr në analizë këto dokumente për të parë ndryshimet e mundshme dhe nëse këto ndryshime kanë reflektuar ndonjë nga çështjet dhe problemet e identifikuara në këtë studim.

4. FILOZOFIA E POLICIMIT NË KOMUNITET

4.1 Zhvillimi i policimit në komunitet

Policimi në komunitet e ka vendosur veten në këto dekadat e fundit si ideologjia dominuese mes formave të tjera të modeleve të policimit demokratik. Ai përbën një ndryshim dramatik në filozofinë që përcakton mënyrë e ndërveprimit të policisë me publikun.

Arsyeja kryesore e është mjedis që ndryshon me shpejtësi, gjë që kërkon teknika të qarta për t'iu përgjigjur problemeve të reja që i dalin strategjive të policimit, të cilat, edhe pse në të kaluarën funksionin mirë, tashmë nuk janë edhe aq efektive.^{viii}

Shumë vende e kanë përqaftuar këtë ideologji pavarësisht historisë dhe normave sociale.

Duke qenë se është filozofi, përkufizimi i policimit në komunitet nuk është i lehtë, sepse lë vend për interpretime dhe perceptime. Gjithsesi, policimi në komunitet ka elementë të caktuar që nuk janë subjekt debati dhe ia vlen të përmenden. Një përkufizim shumë i plotë i policimit në komunitet vjen nga Departamenti i Drejtësisë i ShBA-ve 2014:

“...policimi në komunitet është një filozofi që nxit strategjitë organizative, të cilat mbështetin përdorimin sistematik të partneriteteve dhe teknikave për zgjidhjen e problemeve, për të trajtuar në mënyrë proaktive kushtet imediate që bëjnë të lindin probleme për sigurinë publike, si krimi, mungesa e rendit shoqëror, dhe frika nga krimi.”


Qëllimi kryesor i përqaftimit të filozofisë është ulja e nivelit të kriminalitetit dhe mungesës së rendit, të cilat janë të njëjtat me

filozofinë e policimit tradicional, me ndryshimin se për oficerët e policimit në komunitet ka shumë rëndësi edhe ulja e frikës nga krimi, kaosit social, përmirësimin të shërbimeve të policisë dhe të cilësisë së jetës, si dhe ligjshmëria.^{ix}

Për të arritur këto qëllime afatgjate, tre kolonat kryesore të policimit në komunitet janë: transformimi organizativ, partneritetet në komunitet, dhe zgjidhja e problemeve.

Siç shihet edhe në figurën e mëposhtme, të tre kolonat e policimit në komunitet janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe duhet të trajtohen si të tilla deri në një shkallë të caktuar.

Figura 1. Elementët kryesorë të policimit në komunitet



Burimi: Departamenti i Drejtësisë i SHBA (2014)

Policimi në komunitet kërkon riorganizim të punës së policisë për t'i dhënë kohë zgjidhjes së problemeve në mënyrë 'parandaluese' sesa 'reaguese'. Modeli SARA përdoret gjerësisht në trajtimin e problemeve. Gjithsesi, nuk ka rregull për parandalimin proaktiv ashtu si nuk ka as rregull për

policimin në komunitet. Metodrat e zgjedhura duhet të mbështeten në kontekstin e situatës dhe në varësi të normave ligjore dhe shoqërore të vendit.

4.2 Sfidat dhe implikimet e policimit në komunitet

Policimi në komunitet mbledh një sërë përfaqësuesh filozofike dhe praktike dhe është ende duke u zhvilluar me shpejtësi.^x Kjo nënkupton se nuk ka rregulla për të përfaqësuar këtë ideologji. Tranzicioni drejt saj është i ngadaltë dhe jo i lehtë. Vendet që kanë përfaqësuar këtë filozofi kanë norma të ndryshme kulturore dhe shoqërore, por në të njëjtën kohë vijmë nga regjime të ndryshme, reforma politikash, dhe perceptim komunitar për figurën e policit.

Përshtatja e policimit në komunitet me mjedisin është hapi dhe sfida e parë. Duke qenë se struktura e komunitetit është e ndryshme në çdo vend, madje edhe brenda vendit, nuk ka rregulla të përgjithshme për zbatimin e policimit në komunitet.^{xi} Mosidentifikimi i instrumenteve të përshtatshme dhe përfaqësuesh të duhura në fazën fillestare mund të çojë në moszbatimin me efektivitet deri në dobësi apo mungesë të zbatimit të policimit në komunitet.^{xii} Shumë vende kanë dështuar në zbatimin e parimeve të policimit në komunitet.^{xiii}

Në të njëjtën kohë, nevojitet transformimi dhe përfaqësja shumë-dimensionale (3 kolonat) me qëllim zbatimin e duhur dhe me efektivitet të filozofisë edhe në planin afatgjatë.

Krijimi i angazhimit të komunitetit është një nga aspektet më të vështira të policimit në komunitet.^{xiv}

Element kyç këtu është krijimi i besimit të ndërsjellë nga policia për komunitetin dhe anasjelltas. Për krijimin e këtij besimi duhen kohë dhe përpjekje. Në procesin e ndërveprimit mund të haset në rezistencë nga të dy palët.

Mund të jetë një problem i infrastrukturës dhe mënyra se janë të strukturuar institucionet ose mund të jetë problem për vete aktorët, të cilët mund të mos kenë stimujt e duhur për të nisur procesin për shkak të mungesës së dëshirës, aftësisë apo edhe për shkak të armiqësisë mes individëve që janë pjesë e organizatave.^{xv}

Ndryshimi i institucionit dhe reformimi organizativ janë në përgjegjësi e drejtuesve të lartë të policisë duke qenë se drejtimi funksionon si vertikalisht në institucionin kryesor të policisë ashtu edhe horizontalisht në nivel vendor. Trajnimi i papërshtatshëm, marrja dhe nxitja e vlerave të gabuara apo përhapja e filozofisë së policimit në komunitet vetëm në segmente të caktuara të institucionit të policisë bën që policimi në komunitet të kuptohet jo mirë dhe zbatimi i tij të çalojë në çdo nivel, qendror e vendor.

Një nga sfidat më të mëdha të policimit në komunitet është se edhe pse qëllimi kryesor është ulja e kriminalitetit, në praktikë të dhënat tregojnë se ai ka pak ose aspak ndikim në nivelin e kriminalitetit.^{xvi}

5. POLICIMI NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

5.1 Përqasja normative për zbatimin e policimit në komunitet

PSH ka zbatuar filozofinë e policimit në komunitet, siç u diskutua më sipër, që në vitin 2007, me miratimin e ligjit dhe të strategjisë së PSH i cili synon ndërtimin e partneritetit midis PSH dhe IQV.^{xvii, xviii}

Në fakt, bashkëpunimi mes PSH-së dhe IQV-ve është në vetvete jo i lehtë për t'u arritur për shkak të dallimeve që kanë të dy palët në organizim, në shtrirjen gjeografike, orientimin politik, e kështu me radhë.

Policia e Shtetit është institucion i organizuar në nivel qendror që mbulon dhe vepron në të gjithë vendin. Ajo është e organizuar në 12 drejtori të policisë në qarqe, 43 komisariate, 7 drejtori rajonale të kufirit dhe migracionit dhe 2 rajone policie të kufirit dhe migracionit. Drejtorët e drejtorive rajonale dhe të komisariateve të policisë janë oficerë profesionistë të karrierës që përgjigjen para Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme (MB), një nga ministritë më të rëndësishme politikisht në Shqipëri.


IQV-të veprojnë në një zonë të kufizuar gjeografike dhe administrative dhe drejtohen nga zyrtarët e zgjedhur në nivel vendor që shpesh (mesatarisht 40-60%) përfaqësojnë partitë politike të ndryshme nga ato që drejtojnë nivelin qendror. IQV-të kanë kapacitetet të kufizuara administrative dhe përgjigjen para këshillave të zgjedhur në nivel vendor. Ato kanë kompetenca dhe funksione që i vendosin më pranë nevojave

të qytetarëve dhe vendimet e tyre kanë ndikime të rëndësishme për sigurinë e komuniteteve.

Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013 bazohet në tri shtyllat e policimit në komunitet, me qëllimin përfundimtar krijimin e një mjedis të sigurt përmes vendosjes së partneriteteve dhe strukturave të qëndrueshme të komunitetit.^{xix}

Miratimi i policimit në komunitet nëpërmjet një qasje normative, d.m.th., Ligji për Policinë e Shtetit dhe Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013, kanë mundësuar ndërmarrjen e transformimeve të rëndësishme organizative në Policinë e Shtetit, dhe e vendos “krijimin e partneritetit me komunitetin”, si detyrim ligjor.

Figura 2. Zbatimi i PK në kontekstin shqiptar



Burimi: Ligji 9749/2007;

Nga ana tjetër, ka mjaft ligje që mbështesin policimin në komunitet dhe bashkëpunimin mes PSH dhe IQV-ve, siç jepet në Tabelën 2, më poshtë.

Tabela 2. Ligjet dhe dokumentet e tjera që lehtësojnë zbatimin e policimit në komunitet.

Ligjet	Strategjitë dhe Dokumentet
Ligji 9749/2007 "Për Policinë e Shtetit" neni 122	Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013
Ligji 8927/2002 "Për prefektin"	Strategjia e trajnimit të Policisë 2012-2016
Ligji 8652/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"	Strategjitë vjetore të policimit në qark (SVPQ) (2007-2014)
Ligji 9296/2004 "Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore" (Nenet 12 dhe 14)	Strategjitë e policisë së qarkut çdo tre vjet (2007-2014)
Ligji 9559/2006 , "Për një shtesë në Ligjin 7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope"	<u><i>Ndryshime nga 2014</i></u> Strategjia Kombëtare e Policisë 2015-2021
Ligji 8756/2001 "Për emergjencat civile" (nenet 17,18)	Rregullore e Policisë së Shtetit -2015
VKM Nr. 8/2002 "Për ngritjen e Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, Komiteti Ndërmintor i Sigurisë Rrugore	
<u><i>Ndryshime që nga viti 2014</i></u>	
Ligji 108/2014 "Për Policinë e Shtetit"	
Ligj nr. 30/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar	
Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"	

Edhe pse nuk ka asnjë ligj që detyron bashkitë dhe komunat të bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit, Ligjit Nr. 8927/2002 “Për Prefektin” (nenet 6, 10, 8, 16) i delegon përgjegjësinë Prefektit, i cili është përgjegjës për bashkërendimin e marrëdhënieve midis njësive të qeverisjes vendore dhe Policisë së Shtetit. Për më tepër, Prefekti është përgjegjës për ndërveprimin mes institucioneve të qeverisjes vendore dhe Policisë së Shtetit.

Nga ana tjetër, vetë IQV-të, siç parashikohet në Ligjin 8652/2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” (nenet 3, 4, 10,72), janë përgjegjëse për sigurinë dhe rendin publik si një nga funksionet e veta si dhe si funksion të përbashkët.

Në të njëjtën kohë, ligji thotë se ka fusha të caktuara që policia duhet të bashkëpunojë me bashkitë dhe komunat, si:

Strategjia e Policisë së Shtetit përcakton objektivat dhe instrumentet për arritjen e bashkëpunimit mes PSH dhe IQV-ve. Për të siguruar një bashkëpunim të suksesshëm, strategjia sugjeron se ka nevojë të *përcaktohen linjat e komunikimit* që do të ndihmojnë procesin si dhe të krijohen *struktura të përbashkëta* mes organeve të qeverisjes vendore dhe policisë në nivel vendor. gjithsesi, ka rëndësi që të gjithë aktorët të kenë përgjegjësi të përbashkëta në këtë proces. Inkurajohet të realizohen *takime të rregullta dhe veprimtari të përbashkëta* dhe në të njëjtën kohë të hartohen strategji afatmesme në mënyrë të veçantë për krijimin e partneritetit. Këto masa të drejtohen tek transformimi organizativ dhe ndryshimet në ideologji.

Për të arritur partneritetin me komunitetin dhe zgjidhjen e problemeve, së pari, *Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013*

e konsideron decentralizimin si një proces të rëndësishëm, ekonomikisht por në të njëjtën kohë edhe në procesin e vendimmarrjes.

Po ashtu, Strategjia e Policisë së Shtetit thekson rëndësinë e trajtimit nëpërmjet:

1. Trajnime të përbashkëta mes IQV-ve dhe PSH për të lehtësuar procesin e bashkëpunimit.^{xx}
2. Trajnime për forcat aktuale dhe të reja të policisë për t'i sjellë ata më afër me filozofinë e policimit në komunitet dhe për të mësuar aftësitë e komunikimit. Ky trajnim duhet të ketë aspektet e teorisë dhe praktikës.
3. Trajnim për drejtuesit me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre dhe orientimin e tyre drejt planifikimit strategjik.

Dy vjet pas publikimit të Strategjisë së Policisë së Shtetit, ku përmendej nevoja për trajnime të përbashkët, u hartua strategjia e trajnimeve të PSH pra në dy vitet e para të zbatimit të PK asnjë përgatitje e forcave policore ose e organeve të pushtetit vendor nuk u ndërмор për të lehtësuar bashkëpunimin. Gjithsesi, edhe pas miratimit të strategjisë për trajnimet, në këtë dokument nuk përmenden trajnimet e përbashkëta me IQV-të. Kjo strategji parashikon vetëm aftësimin e forcave të reja policore në Policinë e Shtetit dhe jo forcave ekzistuese dhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë.

Në praktikë policimi në komunitet përbën një modul prej vetëm 10 orësh nga gjithsej 700 orë trajnimi bazë policor, pa bërë një vlerësim të efektivitetit të programeve të tilla.^{xxi} Duke qenë se policimi në komunitet është një përqsasje për të gjithë institucionin e policisë, pjesa trajnimit e destinuar për

informimin dhe udhëzimin e oficerëve të policisë për teorinë dhe praktikën më të mira duket tejet modeste.

Edhe *Infrastruktura dhe Teknologjia* konsiderohen të rëndësishme, përfshirë këtu *reformat në ndërtesat dhe pajisjet e policisë*. *Strategjia të Policisë së Shtetit* parashikon që për të rritur besimin e komunitetit sallahat e drejtimit operativ dhe të emergjencës *duhet të jenë më të gatshme për t'iu përgjigjur shqetësimeve* si dhe kanë nevojë për përmirësime në infrastrukturë dhe kapacitetin e tyre.

Edhe pse strategjia thekson nevojën për përmirësimin e kompetencave dhe përgjegjësiave për çdo rol dhe funksion, ajo nuk parashikon krijimin e një departamenti të ri të destinuar për punonjësit e policimit në komunitet. Përkundrazi, ajo e fokuson këtë seksion tek nxitja e respektimit të hierarkisë policore dhe tek përmirësimi i linjave të komunikimit.

Në fakt, strukturat e përgjithshme të policisë nuk kanë ndryshuar me miratimin e ligjit dhe të strategjisë edhe pse policimi në komunitet kërkon institucione më të 'sheshta dhe horizontale'.

Nga ana tjetër, strategjia parashikon krijimin e një strukture për vlerësimin e performancës si me anë të vetë-vlerësimit ashtu edhe nëpërmjet vlerësimit të jashtëm me qëllim nxitjen e një për qasjeje proaktive nga ana e oficerëve të policisë. Aplikimi i Modelit të Vetë-Vlerësimit si në instancat më të ulëta ashtu dhe tek ato më të larta konsiderohet mjaft i rëndësishëm, edhe pse strategjia nuk ofron ndonjë model konkret që mund të aplikohet.

Gjithashtu, dokumenti i Strategjisë së Policisë së Shtetit nuk përmend ndonjë metodë konkrete apo përjasje për

parandalimin e krimit. Duke qenë se zgjidhja e problemeve është e lidhur ngushtë dhe derivat i partneriteteve të mira dhe i një kulture të përshtatshme menaxhimi, zgjedhja i është lënë në dorë nevojave praktike të oficerëve dhe strukturave të policisë duke konsideruar vetë hartimin dhe zbatimin e SVPQ si qasje për parandalimin e problemeve. Në të njëjtën kohë, Strategjia e Policisë së Shtetit (2007-2013) parashikon hartimin e planeve strategjike çdo 3 vjet së bashku me strategjitë një-vjeçare që kërkohen me ligj.

5.1.1 Ligji dhe Strategjia e re e Policisë së Shtetit

PSH ka adoptuar ligjin e ri 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” si pasojë e analizës së infrastrukturës ligjore dhe organizative të PSH-së, sugjerimeve të partnerëve ndërkombëtarë dhe aktorëve të ndryshëm shtetërorë e të shoqërisë civile, të cilat rezultuan në disa mangësi dhe mungesë koherence me legjislacionin e policimit evropian, e për rrjedhojë ndikonin edhe në treguesit e zbatimit të ligjit e sigurisë në përgjithësi.^{xxii}

Megjithatë, policimi në komunitet vazhdon të jetë filozofia e cila udhëheq policinë e shtetit. Gjithashtu, ligji i ri në nenin 80 përsëri vendos detyrimin e policisë për hartimin e SVPQ në bashkëpunim me aktorët vendorë duke theksuar nevojën e konsultimit edhe me komunitetet fetare dhe shoqërinë civile.

Ligji i ri i policisë nuk vendos më detyrim për sa i përket përmbajtjes së strategjive, por vendos detyrimin e policisë për zbatimin e tyre (pika 3).

Po ashtu, Neni 80 përcakton “Rregulloren e Brendshme të Policisë” si udhëzuesin për hartimin e këtyre strategjive.

Rregullorja e Brendshme e Policisë së Shtetit, e cila është një risi për policinë shqiptare, përcakton afate të detajuara kohore për policinë vendore për hartimin e paraqitjen përfundimtare të SVPK te Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Gjithashtu, risi për sa i përket përmbajtjes të strategjive është “monitorimi” i strategjisë, që kryhet brenda dhe jashtë organizatës nëpërmjet Bordit Konsultativ të Qytetarëve (BKQ) bazuar mbi dëgjesa publike për rezultatet e punës së policisë. Rregullorja parashikon edhe zhvillimin e anketimeve me publikun në nivel vendor.

Për sa i përket strategjisë së re kombëtare (2015-2021), misioni i Policisë së Shtetit është: “Garantimi i zbatimit të ligjit; respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe ruajtja e rendit e sigurisë publike”, me në qendër të vëmendjes shërbimin ndaj individit dhe mbrojtjen e qytetarit.^{xxiii}

Në hartimin e kësaj strategjie, PSH ka ndërmarrë edhe në bashkëpunim me donatorë dhe aktorë të tjerë një sërë studimesh për të parë nevojat afatgjata të policisë.^{xxiv} Por, nuk është realizuar asnjë studim në lidhje me efektivitetin e bashkëpunimit midis PSH dhe IQV.

Kjo strategji përsëri, ashtu si ajo e mëparshme, vendos theksin në rëndësinë që ka bashkëpunimi me IQV dhe aktorët e tjerë vendorë në funksionimin e policisë dhe zbatimin e policimit në komunitet por në ndryshim nga strategjia e mëparshme, kjo strategji kombëtare nuk parashikon metoda specifike për arritjen e partneritetit.^{xxv}

Në të vërtetë, theksi në pjesën më të madhe të përmbajtjes së strategjisë vendoset mbi ndryshimet organizative në PSH në nivel qendror dhe vendor për të lehtësuar qasjen “proaktive”

të policisë si dhe për përafrimin e standardeve të institucionit të policisë me ato të BE:^{xxvi}

“Organizimi i ri i PSH-së do të synojë ristrukturimin dhe konsolidimin e të gjithë sistemit, duke thjeshtuar strukturat, duke shkurtuar nivelet e drejtimit dhe shkallët e komunikimit, duke ridimensionuar përgjegjësitë për çdo funksion e post pune, duke shtuar ngarkesën e punës dhe fuqizuar kompetencat, duke saktësuar raportet dhe procedurat standarde të punës, duke rivlerësuar personelin sipas vlerave dhe meritokracisë së punonjësve, si dhe duke ngritur mekanizma që garantojnë komunikimin e bashkëpunimin ndërinstitutional efektiv me aktorët e tjerë të sigurisë.”

5.2 Miratimi i rregullt i SVPQ

Komponentët e mëposhtëm të ligjit do të jenë treguesit që do të përdoren për të vlerësuar rregullsinë e SVPQ si në aspektin e sasisë ashtu edhe në atë të përmbajtjes:

- A. Ligji nr. 9749/2007 “Për policinë e shtetit”, neni 122 (pika 1) vendos detyrimin drejtorëve të policisë në qark të përpilojnë *Strategji Vjetore të Policimit në Qark* pas konsultimeve me përfaqësuesit e organeve të pushtetit vendor (*prefekti, krye-bashkiakë dhe kryekomunarë*), *përfaqësuesit e institucioneve të pushtetit vendor si dhe përfaqësues të grupeve të interesit*.
- B. Në të njëjtën kohë (pika 4), strategjia duhet të paraqitet pranë IQV paraprakisht dhe më pas pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili duhet të miratojë strategjinë së bashku me Grupin e Politikave në muajin janar. (pika 6)
- C. Ligji (pika 3) vendos një detyrim përsa i përket përmbajtjes së strategjive. Të gjitha strategjitë:

1. Duhet të bëjnë një vlerësim të kriminalitetit në qarkun përkatës për vitin paraardhës.
2. Duhet të identifikojnë mënyrat sesi shqetësimet e komunitetit janë përmbushur.
3. Të shprehin qartësisht angazhimin për një bashkëpunim të vazhdueshëm me anëtarët e komunitetit.
4. Të japin rekomandime për të ulur numrin e veprave penale dhe shkeljeve të tjera të ligjit.

5.2.1 Sasia

Me sasi do të kuptojmë përpilimin e SVPQ çdo vit dhe në çdo qark rregullisht duke prodhuar 12 strategji policimi në vit dhe 7 strategji policimi për çdo qark. Numri total i strategjive që duhet të jenë përpiluar është 84. Nëse vëzhgojmë tabelën e mëposhtme shihet qartë se strategjitë kanë qenë të rregullta për sa i përket përpilimit të tyre.

Tabela 3. Ekzistenca e SVPQ në nivel qarku

Ekzistenca e SVPQ	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës	*	*	*	*	*	*	*
Korçë	*	*	*	*	*	*	*
Vlorë	*	*	*	*	*	*	*
Berat	*	*	*	*	*	*	*
Durrës	*	*	*	*	*		*
Tiranë	*	*	*	*	*		*
Lezhë	*	*	*	*	*	*	*
Shkodër	*	*	*	*	*		*
Fier	*	*	*	*	*		*
Elbasan	*	*	*	*	*		*
Gjirokastrër	*	*	*	*	*		*
Dibër	*	*	*	*	*		*

E verdhë: Strategjitë nuk janë mundësuar.

Mbledhja e strategjive të vitit 2013 nuk ka qenë e mundur nëpërmjet DPP, pasi këto dokumente janë të klasifikuara,^{xxvii} por ka qenë e mundur mbledhja e disa prej tyre përmes DPQ. Bazuar në prirjet e vëzhguara, mund të thuhet se këto dokumente ekzistojnë dhe se ka pasur angazhim në nivel vendor për të përpiluar strategjitë nga ana e policisë.

5.2.2 Përmbajtja

Me përmbajtje do të kuptojmë përpilimin e strategjive sipas kërkesave të ligjit. Strategjitë janë analizuar në mënyrë të njëpasnjëshme dhe janë vlerësuar për të parë në cilat pika strategjitë individuale i përmbushin detyrimet ligjore dhe në cilat pika ato nuk arrijnë t'i përmbushim për të sjellë më pas prirjet e përgjithshme. Në lidhje me aspektin përmbajtësor, strategjitë janë 20-25 faqe dhe janë të përbëra nga faqja e parë, përmbajtja dhe faqja e fundit. Është interesante të përmendet se detyrimet e ligjit për sa i përket përmbajtjes janë të tilla pa të cilat, strategjitë nuk mund të bëhen të aplikueshme, nëse këto detyrime nuk përmbushen duke bërë që strategjitë të mos të jenë efektive.

5.3 Data dhe Firmat

5.3.1 Firma e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë

Në faqen e parë mund të gjendet firma e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë (DPP). Vetëm në **1 strategji, atë të Beratit**, mungon firma e DPP duke e bërë këtë strategji të pazbatueshme nga kjo drejtori policie për vitin 2008. Kjo strategji, siç do të shohim më poshtë, ka pasur mjaft probleme

në përmbajtjen e saj duke e bërë atë joefektive për t'u zbatuar dhe të pamiratueshme nga DPP.

Tabela 4. Firmosja nga Drejtori i Policisë (DPP)

Firma DPP	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës	*	*	*	*	*	*	*
Korçë	*	*	*	*	*	*	*
Vlorë	*	*	*	*	*	*	*
Berat		*	*	*	*	*	*
Durrës	*	*	*	*	*		*
Tiranë	*	*	*	*	*		*
Lezhë	*	*	*	*	*	*	*
Shkodër	*	*	*	*	*		*
Fier	*	*	*	*	*		*
Elbasan	*	*	*	*	*		*
Gjirokastrë	*	*	*	*	*		*
Dibër	*	*	*	*	*		*

E kuqe: Jo e rregullt. E verdhë: Strategjitë nuk janë mundësuar.

5.3.2 Firma e Drejtorit të të Policisë së Qarkut

Në faqen e fundit mund të gjendet firma e Drejtorit të Policisë së Qarkut (DPQ), i cili është përgjegjësi sipas ligjit për hartimin e strategjive në nivel vendor. Vendosja e firmës së tij sugjeron se ai pranon përgjegjësinë e hartimit dhe të lëshimit të dokumentit. 2 strategji nga 77 nuk e zotërojnë firmën e DPQ ato të Beratit dhe Durrësit për vitin 2008.

Tabela 5. Firmosja nga Drejtori i Policisë së Qarkut (DPQ)

Firma DPQ	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës	*	*	*	*	*	*	*
Korçë	*	*	*	*	*	*	*
Vlorë	*	*	*	*	*	*	*
Berat		*	*	*	*	*	*
Durrës		*	*	*	*		*
Tiranë	*	*	*	*	*		*
Lezhë	*	*	*	*	*	*	*
Shkodër	*	*	*	*	*		*
Fier	*	*	*	*	*		*
Elbasan	*	*	*	*	*		*
Gjirokastrë	*	*	*	*	*		*
Dibër	*	*	*	*	*		*

E kuqe: Jo e rregullt; E verdhë: Strategjitë nuk janë mundësuar.

Siç mund të vihet re, strategjia e Beratit nuk është miratuar as nga DPP dhe as nga DPQ, por është e shkruar dhe arkivuar në dokumentet zyrtare në të dyja drejtoritë e policisë. Në anën tjetër, strategjia e Durrësit është miratuar nga DPP, pa miratimin përfundimtar të DPQ. 75 strategjitë e tjera janë miratuar nga DPP dhe DPQ, pra ato janë të rregullta në përmbajtje dhe janë lejuar për t'u zbatuar në praktikë.

5.3.3 Data e Miratimit të SVPQ

Në faqen e parë, gjithashtu, mund të gjendet vendi dhe data e miratimit të strategjisë, por nuk është saktësuar nëse është data e miratimit nga DPP apo nga DPQ duke qenë se këto data variojnë nga nëntori në prill dhe nga Tirana në nivel qarku.

Në secilin rast, ka mospërputhje me ligjin, pasi SVPQ duhet të miratohet nga DPP dhe Grupi i Politikave në muajin janar, pra

dhe procesi i miratimit nga ana e DPQ duhet të ketë përfunduar përpara kësaj date.

Tabela 6. Data e miratimit të SVPQ

Data e miratimit	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës		*	*				*
Korçë	*		*				*
Vlorë	*		*			*	*
Berat	*		*			*	*
Durrës	*		*		*		*
Tiranë	*		*		*		*
Lezhë	*		*				*
Shkodër			*				*
Fier	*		*				*
Elbasan			*				*
Gjirokastër			*				*
Dibër	*		*				*


E kuqe: Jo e rregullt; E verdhë: Strategjitë nuk janë mundësuar.

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, vetëm 34 nga 77 strategji janë miratuar brenda afatit që parashikon ligji. Në viti 2010 dhe 2014 të gjitha strategjitë janë miratuar në kohë, pra ato i përmbushin afatet kohore jo vetëm përballë ligjit, por gjithashtu janë më lehtë të zbatueshme për sa i përket planit të parashikuar të punës . Në vitin 2009 dhe 2011 të tëra strategjitë janë miratuar në muajt mars-prill duke i bërë këto strategji të vështira për t'u zbatuar në praktikë duke qenë se aktivitetet e planifikuara për çerekun e parë të vitit nuk janë më të realizueshme për efekt kohor.

5.3.4 Detyrimi për t'ia paraqitur strategjinë IQV përpara miratimit nga DPP

Sipas Ligjit për Policinë e Shtetit, DPQ ka detyrimin që t'i paraqesë IQV të qarkut strategjinë e policisë përpara dërgimit për miratim nga DPP dhe Grupi i Politikave.

Figura 3. Shpërndarja paraprake e SVPQ-ve Institucioneve të pushtetit vendor



Bazuar mbi 125 letrat e dërguara IQV dhe vetëm 14 përgjigjeve të marra:

- 12/ 14 deklarojnë se nuk e kanë parë asnjëherë përmbajtjen e SVPQ,
- 1/ 14 deklarojnë se e kanë parë përmbajtjen e SVPQ, por nuk e zotërojnë në arkivat e tyre dhe
- 1/14 deklarojnë se nuk janë në dijeni të ekzistencës së SVPQ, por se kanë një marrëdhënie të mirë me Policinë e Shtetit.

Bazuar mbi këto informacione mund të themi se policia ka dështuar në shpërndarjen e informacionit dhe të strategjive në IQV duke mos qenë konform ligjit (B, pika 5). Në të njëjtën kohë kjo tregon se PSH nuk ka arritur të përfshijë IQV në hartimin e SVPQ.

5.3.5 Raportimi i Veprave Penale (C pika 1)

Në kapitullin e tyre të parë (Identifikimi dhe vlerësimi i situatës aktuale), SVPQ përshkruajnë situatën e sigurisë për vitin e mëparshëm si dhe punën dhe aksionet e ndërmarra nga policia për ruajtjen e rendit dhe qetësisë.

Sektorët e përfshirë nga policia në të gjitha SVPQ janë: Sektori kundër Krimeve të Rënda, Sektori i Policisë Rrugore, Sektori kundër Krimeve Terroriste, Sektori kundër Kultivimit dhe Përdorimit të Narkotikëve, Sektori për Krimet Financiare dhe Ekonomike, Sektori kundër Dhunës në Familje dhe Sektori i Sigurisë Publike.

Nëse i rikthehemi tabelës së mësipërme, policia është e detyruar me ligj të reagojë ndaj problemeve në sektorët e sipërpërmendur. Është e vështirë të gjenden në strategji informacion rreth çështjeve dhe problematikave të cilat komuniteti has, siç do e shikojmë në vijueshmëri të analizës duke sugjeruar për një qasje “reaktive” dhe jo të bazuar në kontekstin ku policia e qarkut operon.

Është e mundur që në SVPQ të gjenden statistikat për vitin paraardhës mbi këto sektorë dhe gjithashtu statistika të përmbledhura të veprave penale duke plotësuar kërkesat e ligjit (C, pika 1).

Tabela 7. Raportimi i Krimeve të një viti më parë.

Raportim i Krimeve	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës	*	*	*	*	*	*	*
Korçë	*	*	*	*	*	*	*
Vlorë	*	*	*	*	*	*	*
Berat				*	*	*	*
Durrës	*	*	*	*	*		*
Tiranë	*	*	*	*	*		*
Lezhë	*	*	*	*	*	*	*
Shkodër		*	*	*	*		*
Fier	*	*	*	*	*		*
Elbasan			*	*	*		*
Gjirokastër	*	*	*	*	*		*
Dibër	*	*	*	*	*		*

E kuqe: Jo e rregullt; E verdhë: Strategjitë nuk janë mundësuar.

Bazuar mbi të dhënat e mundësuar nga SVPQ, 6 strategji nuk kanë raportuar mbi krimet e një viti më parë. Këto statistika nuk mund te gjenden për tre vite rresht në Qarkun e Beratit duke ndërtuar planet e punës dhe vetë strategjinë e viteve 2008-2011 jo të bazuar mbi kontekstin e vendit dhe mbi nevojat e komuniteteve, të cilat mbulohen nga kjo drejtori. Rrjedhimisht strategjitë nuk mund të jenë efektive gjatë zbatimit. E njëjta situatë evidentohet edhe për SVPQ e Elbasanit 2008-2010.

5.3.6 Angazhimi për të bashkëpunuar me komunitetin (C, pika 3)

Në kapitullin e dytë të tyre (Misioni dhe Vizioni) strategjitë deklarjnë qartësisht qëllimin dhe përkushtimin e tyre “për të

bashkëpunuar me komunitetin në luftën dhe parandalimin e krimit për arritjen e rendit dhe sigurisë publike”. Në këtë mënyrë, SVPQ janë në përputhje me kërkesat e ligjit (C, pika 3).

Tabela 8. Shprehja qartë e angazhimit për përfshirjen e komunitetit në policim

Shprehja e angazhimit	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës	*	*	*	*	*	*	*
Korçë	*	*	*	*	*	*	*
Vlorë	*	*	*	*	*	*	*
Berat		*	*	*	*	*	*
Durrës	*	*	*	*	*		*
Tiranë	*	*	*	*	*		*
Lezhë	*	*	*	*	*	*	*
Shkodër		*	*	*	*		*
Fier	*	*	*	*	*		*
Elbasan	*	*	*	*	*		*
Gjirokastrë	*	*	*	*	*		*
Dibër	*	*	*	*	*		*

E kuqe: Jo e rregullt; E verdhë: Strategjitë nuk janë mundësuar.

Vetëm 2 strategji nuk janë të rregullta. Mungesa e kësaj deklarate nuk sjell asnjë problem në vetvete, pasi policia është e mandatar me ligj që të sigurojë ruajtjen e rendit dhe sigurisë dhe po ashtu të përfshijë komunitetin në policim.

5.3.7 Trajtimi i problemeve të komunitetit (C, pika 2)

Pavarësisht se SVPQ deklarojnë qartësisht se do të bashkëpunojnë me komunitetin, nuk është e qartë sesi strategjitë në radhë të parë përcaktojnë dhe në radhë të dytë trajtojnë nevojat dhe problemet e komunitetit. Në SVPQ

secilës prej kërkesave të ligjit i është vënë në dispozicion një kapitull ose seksion qartësisht i dallueshëm, përveç një kapitulli ose seksioni ku shpjegohet sesi policia ka trajtuar problemet e komunitetit.

Gjithsesi, 25/77 SVPQ kanë përfshirë një listë ose paragraf në lidhje me shqetësimet e komunitetit. Disa prej këtyre paragrafëve janë perceptime të policisë rreth problemeve të cilat komuniteti has dhe jo të vetë aktorëve.

Disa nga këto shqetësime përfshijnë: kultivimin dhe përdorimin e lëndëve narkotike (veçanërisht në shkolla), shkallën e lartë të kriminalitetit, dhunës në familje dhe shfrytëzimit të të miturve, nevojën për një prani të lartë të policisë në mjediset publike, si dhe problem të tjera mjedisore ose konfliktuale. Siç kemi përmendur më parë, disa nga këto shqetësime janë një përgjegjësi e sektorëve të veçantë dhe vetë institucionit të policisë, siç përcaktohet me ligj,^{xxviii} dhe SVPQ raportojnë rreth punës së bërë për të trajtuar këto probleme. Faktikisht, kjo është një mënyrë për të trajtuar problemet e komunitetit.

Por, në anën tjetër, kapitulli i tretë i SVPQ (Prioritetet Strategjike) përmban një listë përparësish ndaj të cilave policia e qarkut duhet të fokusojë punën e saj në vitin pasardhës.

Ajo që policia trajton si prioritare nuk është e njëjtë me atë që komuniteti trajton si të tillë. Në qoftë se ne duam që të vendosim dy lista krahas krahas për të gjetur ngjashmëritë, mund të themi se ekzistojnë rastësi ku mund të ketë përputhje mes kërkesave të komunitetit dhe përparësive të policisë,^{xxix} por në përgjithësi ato nuk gjejnë lidhje të përbashkëta.

Gjithashtu, në SVPQ mund të gjenden raportime për numrin e telefonatave të marra nga komuniteti në numrat e telefonit të

ofruara nga policia. 16/77 SVPQ japin statistika rreth telefonatave, por asnjë prej tyre nuk raporton mbi numrin e telefonatave dhe ankesave ndaj të cilave policia ka reaguar dhe ka marrë masat e duhura.

Si përfundim, mund të themi se për sa i përket kërkesave të ligjit asnjë prej strategjive nuk e përmbush kriterin e mësipërm:

Tabela 9. Trajtimi i problemeve të komunitetit.

Trajtimi i problemeve	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës							
Korçë							
Vlorë							
Berat							
Durrës							
Tiranë							
Lezhë							
Shkodër							
Fier							
Elbasan							
Gjirokastër							
Dibër							

E kuqe: Jo e rregullt; E verdhë: Strategjitë nuk janë mundësuar.

Në të vërtetë bashkëpunimi me komunitetin dhe përgjigja ndaj nevojave të tyre është një ndër prioritet si të filozofisë së policimit në komunitet, po ashtu dhe të ligjit dhe strategjisë së policisë. Mos-trajtimi i këtyre problemeve i bën strategjitë joefikase për të parandaluar si dhe jo në përputhje me parimet bazë të policimit në komunitet.

5.3.8 Rekomandime për uljen e veprave penale (C, pika 4)

Në kreun 5 (Plani i Veprimit) jepet një listë e detajuar të planeve për të arritur qëllimet dhe prioritetet e përcaktuara në kreun 3 (Prioritetet Strategjike). Ajo është e organizuar në një tabelë si më poshtë:

Formati i organizimit të rekomandimeve nw SVPQ

Prioriteti Strategjik Nr. 1 “_____”

Nr.	Masat për t'u ndërmarë	Afati Kohor	Sektori përgjegjës
1.(1)	Masa 1	Datë/Në vazhdimësi	Sektor / Komisarjat
1.(2)	Masa 2	Datë/ Në vazhdimësi	Sektor/Komisariat

Çdo objektiv ka një shtrirje të vetën, ku janë përcaktuar të gjitha masat që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin, një afat zbatimi, (që mund të jetë një datë të caktuar ose një “proces i vazhdueshëm”) sektori i ngarkuar për zbatimin. Në disa SVPQ ekziston një kolonë shtesë e cila përcakton koston e zbatimit.

Me marrjen e këtyre masave, policia ka si qëllim përfundimtar uljen e numrit të veprave penale, ruajtjen e rendit dhe qetësisë si dhe arritjen e treguesve sasiorë dhe cilësorë të performancës të përcaktuara në SVPQ.

Tabela 11. Rekomandime për uljen e numrit të veprave penale

Qarku	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës	*	*	*	*	*	*	*
Korçë	*	*	*	*	*	*	*
Vlorë	*	*	*	*	*	*	*
Berat		*	*	*	*	*	*
Durrës	*	*	*	*	*		*
Tiranë	*	*	*	*	*		*
Lezhë	*	*	*	*	*	*	*
Shkodër	*	*	*	*	*		*
Fier	*	*	*	*	*		*
Elbasan	*	*	*	*	*		*
Gjirokastrë	*	*	*	*	*		*
Dibër	*	*	*	*	*		*

E kuqe: Jo e rregullt; E verdhë: Strategjitë nuk janë mundësuar.

Vetëm një strategji nuk përmban rekomandime për uljen e numrit të veprave penale. Pra, strategjia e Beratit, përveç arsyeve të tjera të cilat i përmendëm më sipër, nuk përmban planin e masave të policisë dhe kjo e bën këtë strategji të pazbatueshme.

Në anën tjetër, duke qenë se rekomandimet nuk janë në përputhje me nevojat e komunitetit dhe nuk janë të bazuara në kontekstin e vendit, nuk mund të jenë efektive si në uljen e krimit dhe ruajtjen e qetësisë, po ashtu edhe në zbatimin e policimit në komunitet.

5.4. Përmbledhja e gjetjeve në lidhje me përputhshmërinë në rang kombëtar dhe efektiviteti i zbatimit të SVPQ

Duke filluar analizën nga viti 2008 duke lëvizur në vitin 2014 mund të vërehet se në vitin 2008 dhe 2009 kanë ekzistuar probleme të dukshme në aspektin e rregullsisë së përmbajtjes duke qenë një proces i ri si për policinë në nivel qendror po ashtu dhe për atë në nivel vendor. Strategjitë e Beratit dhe Shkodrës nuk i plotësojnë kriteret e SVPQ të përcaktuara në ligj dhe kryesisht përshkruajnë në aspektin teorik atë që është filozofia e policimit në komunitet por pa ndërtuar një plan masash që do të merren në drejtim të arritjes së këtij objekti.

Vetëm në vitin 2010 SVPQ kanë arritur të ndërtojnë një strukturë të përbashkët siç përshkruhet më sipër. Gjithsesi, strategjitë vazhdojnë të shfaqin parregullsi jo më në lidhje me strukturën por në lidhje me:

- datën e miratimit të tyre që i bën strategjitë jo plotësisht efektive për shkak të afateve të kufizuara kohore
- dhe me dështimin për të trajtuar problemet e komunitetit dhe për të përfshirë institucionet vendore përpara miratimit përfundimtar, që është edhe thelbi i policimit në komunitet dhe ndërtimit të partneritetit.

Siç mund të shihet nga tabelat e mëposhtme (përmbledhja e tabelave të sipërpërmendura), realisht asnjë prej SVPQ nuk mund të jenë efektive dhe përfaqësuese e komuniteteve vendore. Gjithsesi, edhe nëse këto strategji do të kishin përfshirë komunitetin në hartimin e tyre, përsëri parregullsitë e tjera të shfaqura do i bënë gjysmën e këtyre strategjive të vështira për t'u zbatuar në praktike dhe jo-plotësisht efektive.

Tabela 12. SVPQ që janë të rregullta përsa i përket kërkesave të ligjit (pa trajtimin e shqetësimeve)

Qarku	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës		*	*				*
Korçë	*		*				*
Vlorë	*		*			*	*
Berat						*	*
Durrës			*		*		*
Tiranë	*		*		*		*
Lezhë	*		*				*
Shkodër			*				*
Fier	*		*				*
Elbasan			*				*
Gjirokastrë			*				*
Dibër	*		*				*

Tabela 13. SVPQ që janë të rregullta përsa i përket kërkesave të ligjit (me trajtimin e shqetësimeve)

Qarku	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kukës							
Korçë							
Vlorë							
Berat							
Durrës							
Tiranë							
Lezhë							
Shkodër							
Fier							
Elbasan							
Gjirokastrë							
Dibër							

Të dy tabelat: E kuqe: Jo e rregullt; E verdhë: Strategjitë nuk janë mundësuar.

Në një analizë pak më të thellë të strategjive është e mundur të vëzhgohet se strategjitë janë mjaft të ngjashme jo vetëm në formë por edhe në përmbajtje ku strategjitë e 2008 dhe 2009 kanë ngjashmëri dhe përsëritje midis qarqeve,^{xxx} ndërsa duke nisur nga viti 2010 strategjitë janë pothuajse të njëjta në përmbajtje për të njëjtin qark. Kjo dëshmon për një cilësi të dobët të strategjive si dhe për një hartim formal të tyre.

Gjithashtu, është mjaft interesante të vëzhgohet se SVPQ janë miratuar nga DPQ dhe DPP pavarësisht mangësive të tyre dhe mospërputhshmërisë me kërkesat e ligjit. Një dukuri e tillë tregon për një përgatitje dhe trajnim të dobët të strukturave policore për të hartuar dhe vlerësuar dokumentet strategjike bazuar mbi ligjin shqiptar si dhe filozofinë e policimit në komunitet.

5.4.1 Ndikimi

Në të vërtetë, siç mund të shihet nga grafikët e mëposhtëm të ndërtuar me të dhënat e mbledhura nga vetë SVPQ, zbatimi i këtyre strategjive si dhe i policimit në komunitet nuk ka pasur ndikim mbi numrin e veprave penale. Edhe pse praktika shumë-vjeçare në vendet e tjera ka treguar se adoptimi i policimit në komunitet nuk rezulton gjithmonë në uljen e veprave penale, strategjia kombëtare e policimit e viteve 2007-2013 e vendos si një ndër prioritete e saj kryesore.^{xxxi}





Jo vetëm strategjia kombëtare e policisë, por edhe SVPQ e përcaktojnë uljen e shifrave të veprave penale një prioritet dhe një tregues performance në kapitullin 4 (Treguesit e Performancës). Treguesit e përzgjedhur janë ndarë në tregues cilësorë dhe sasiorë.

Ky kapitull është ndërtuar mbi bazën e Strategjisë Kombëtare të Policimit 2007-2013, e cila përcakton matjen e performancës si një metodë të rëndësishme të vetë-vlerësimit dhe vlerësimit të performancës së institucionit,^{xxxii} drejt rrugës për zbatimin e plotë të policimit në komunitet.

Treguesit cilësorë nuk mund të maten dhe të përcaktojnë qëllimet afatgjata të zbatimit të strategjisë. Ato mund të përmbliidhen në: perspektivë për të rritur besimin dhe bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit me IQV dhe aktorët e tjerë në komunitet, parandalimin dhe luftimin e krimit dhe veprave penale, përmirësimin e performancës së policisë, etj.

Treguesit sasiorë mund të maten mjaft lehtë dhe bëjnë të mundur ndjekjen e procesin të zbatimit dhe performancës. Ata ndryshojnë sipas njësisë vendore dhe vitit por 77/77 SVPQ kanë synuar për një rënie 5-10% në numrin e përgjithshëm të veprave penale dhe një rritje 5-10% në normën zbulimit të krimeve.

Grafiku 1. Veprat Penale në katër qarqet e përzgjedhura (të dhënat nga SVPQ) 2007-2013



Burimi: SVPQ (2007-2014) Kukës, Vlorë, Durrës Gjirokastrë (nga e majta në të djathtë).

Është e mundur të shihet në grafikët e mësipërm se nuk ka pasur ulje në numrin e veprave penale nga 2007-2013 për asnjë nga rajonet e përzgjedhura (pavarësisht diversitetit në problemet e sigurisë), ku në fakt ka pasur një rritje të këtyre vlerave.

Gjithashtu, kurba, e cila paraqet numrin e veprave penale të zbuluara nga policia në vitin paraardhës (e ndërtuar mbi të


dhënat e grumbulluara nga SVPQ), ecën në mënyrë paralele me kurbën që paraqet numrin e veprave penale. Pra, jo vetëm kriminaliteti nuk ka pësuar ulje, por edhe aftësia e policisë për të zbuluar dhe rrjedhimisht për të parandaluar nuk është zhvilluar.

5.4.2 Bashkëpunimi me IQV


“Nevoja për bashkëpunim me IQV” është gjurmuar bazuar mbi informacionet e mbledhura në SVPQ. Në qoftë se bashkëpunimi ndërmjet PSH dhe IQV dhe ndërvarësia do të ishte rritur ndër vite, kjo do të shfaqej në strategjitë vjetore duke përfshirë këta aktorë në planin e veprimit të vitit vijues.

Siç shihet nga grafiku. 2, “Nevoja për Bashkëpunim me IQV” nuk ka ndryshuar në mënyrë drastike me dallime të vogla ndërmjet qarqeve.

Grafiku. 2 Nevoja për bashkëpunim me IQV sipas qarqeve



Grafiku 3. Nevoja për bashkëpunim me IQV në vite



Burimi: SVPQ 2007-2014 (përfshirë 2013)^{xxxiii}

Edhe pse vlerat janë dyfishuar nga 2008 në 2012, bazuar mbi një analizë të përbajtjes së planeve të veprimit, të cilat përfshijnë bashkëpunimin me IVP, vit pas viti, nevoja e ndërveprimit me aktorët vendorë lidhet me përfshirjen e tyre në zhvillimin e fushatave të përbashkëta sensibilizuese në informimin mbi çështje të caktuara të grupeve të ndryshme të komunitetit. Policia nuk ka mundur të hartojë plane veprimi më të plota në bashkëpunim me aktorët vendorë duke mos i përfshirë ata mjaftueshëm në zbatimin e SVPQ.

5.4.3 Praktika e bashkëpunimit midis PSH dhe IQV

Bazuar mbi gjetjet e SVPQ rreth bashkëpunimit me IQV, duket se PSH nuk ka arritur të përfshijë IQV në hartimin dhe zbatimin e këtyre strategjive.

Në bazë të informacioneve të mbledhura nga 40 intervistat me kryetarët e bashkive dhe komunave në katër qarqet e përzgjedhura, argumenti i mësipërm mbështetet edhe prej tyre.^{xxxiv} Në disa raste kryetarët e komunave nuk janë as të vetëdijshëm për ekzistencën e SVPQ dhe mbi të drejtën e tyre për të kontribuar apo se çfarë do të thotë policim në komunitet.^{xxxv}

Institucioni në nivel vendor me të cilin policia ka një bashkëpunim më të qëndrueshëm është Prefekti, edhe pse sipas ligjit, policia ka për detyrë të raportoje dhe të përgjigjet para këtij institucioni, ndërsa me institucionet e tjera të pushtetit vendor është çështje e angazhimit dhe dëshirës së mirë dypalëshe. Bazuar në këto evidenca mund të themi se edhe Prefekti nuk ka arritur të shërbejë si urë lidhëse efektive midis PSH dhe IQV ashtu siç parashikon dhe mundëson ligji.

Në anën tjetër, PSH dhe IQV kanë pasur kontakt të vazhdueshëm ndër vite, pavarësisht mungesës së përfshirjes së IQV në hartimin dhe zbatimin e SVPQ. Ky ndërveprim ndryshon sipas qarqeve dhe zonave. Në disa zona ndërveprimi ka qenë më i shpeshtë dhe në disa të tjera më i rrallë. Takimet kanë qenë kryesisht formale ku Policia e Shtetit dhe IQV mblidhen për një tematikë të caktuar, por edhe informale në zona më të vogla rurale, ku policia paraqitet edhe përditë në zyrën e kryetarit të komunës. Nga informacionet e mbledhura nga SVPQ, shihet gjithashtu se takime janë zhvilluar në të gjitha qarqet.

Çështjet e diskutuara si në takimet formale dhe në ato joformale janë kryesisht të lidhura me lëndët narkotike dhe veprat e tjera penale, të iniciuara nga ana e policisë, por në disa raste policia është përfshirë në skenarë të tjerë, si

problemet e ujit dhe të mjedisit, edhe pse drejtuesit e pushtetit vendor thonë se janë ata të cilët kanë iniciuar përfshirjen e policisë.

Takimet formale në disa raste kanë përfshirë aktorë të tjerë, edhe pse drejtuesit e pushtetit vendor raportojnë për një frekuencë të ulët të pranisë së tyre. Institucionet e përfshira janë kryesisht shkollat dhe institucionet e lidhura me arsimin. Aktorët e tjerë vendorë zakonisht nuk janë të përfshirë përveç në situata emergjente. Qëllimi i takimeve lidhet përgjithësisht me problemin e lëndëve narkotike nga ana e nxënësve dhe parandalimin e konflikteve të dhunshme. Këto takime synojnë të rrisin ndërgjegjësimin për konsumin e lëndëve narkotike, por në të njëjtën kohë të paraqesin figurën e policit si të besueshëm dhe pozitiv.

Kutia 1. Policimi ne zonat rurale dhe urbane

Është konstatuar se ekziston një dallim mes policimit në zonat e vogla rurale dhe në zonat urbane. Në komunat e vogla dhe fshatra, inspektorët e policisë kanë krijuar një marrëdhënie të ndërsjellë me kryeplakun e fshatit dhe jo me kryetarin e komunës duke e konsideruar atë një burim të besueshëm informacioni¹. Gjithashtu, policia në këto zona është më afër komunitetit me qëllim parandalimin e krimit nëpërmjet vëzhgimeve më të shpeshta dhe të imta dhe krijimit të një marrëdhënie më të ngushtë me anëtarët e komunitetit¹. Pavarësisht se në këto zona qasja është “proaktive”, kjo ka ardhur më së shumti si nevojë për shkak të një mbulimi të gjerë të territorit nga një inspektor i vetëm policie.

Në zonat urbane, nuk evidentohet prirja e mësipërme për shkak të lëvizshmërisë së lartë të popullsisë dhe problemeve të shumëllojshme të sigurisë, por edhe për shkak të faktit se zhvendosjet e policisë janë të shpeshta duke krijuar një qasje më shumë “reaguese” të punonjësve të policisë në këto zona. Në qytetet kryetarët e bashkive thonë se prania e patrullave policore duket se është rritur gjë që ka krijuar rritjen e ndjesisë së sigurisë për komunitetin, por nga ana tjetër në vendet turistike rritja e pranisë së policisë bën që turistët të ndjehen të frikësuar.

Por në anën tjetër, pavarësisht takimeve të zhvilluara, IQV argumentojnë se marrëdhënia e tyre me policinë vendore ka qenë pozitive, por ka qëndruar në nivele formale. IQV nuk kanë arritur të përfshihen në punën e përditshme të policisë.

Nga intervistat me kryetarët e pushtetit vendor, besimi i komunitetit në PSH është rritur, por kjo rritje është e brishtë dhe e pakonsoliduar. Komuniteti është përgjithësisht i paqartë në lidhje me rolet dhe detyrat e policisë dhe i konsideron dështimet e prokurorisë dhe gjyqësorit si dështime të policisë duke minuar përpjekjet e policisë për të krijuar dhe rritur besimin.

Siç u përmend më parë, duke qenë se SVPQ dështojnë në trajtimin e shqetësimeve të komunitetit, kjo tregon se takimet nuk kanë qenë të suksesshme në arritjen e qëllimit të tyre për krijimin e marrëdhënieve të ndërsjella dhe të strukturave komunitare. Policimi në komunitet deri më tani është parë si një përpjekje për të hapur policinë ndaj publikut, por jo për të vendosur lidhje konkrete për të parë se çfarë dëshiron publiku nga policia.^{xxxvi}

5.5 Faktorët që lehtësojnë dhe vështirësojnë Zbatimin e SVPQ dhe Bashkëpunimin midis PSH dhe IQV

Komuniteti i donatorëve dhe asistencës së huaj, që ka luajtur një rol të rëndësishëm në miratimin e PK, ka qenë aktiv në procesin e zbatimit dhe vlerësimit të tij. Përveç ndihmës së drejtpërdrejtë të dhënë për Policinë e Shtetit për zbatimin e PK, shumë prej projekteve janë fokusuar në vlerësimin e zbatimit të policimit në komunitet.

Duke pasur parasysh se modeli i policimit në komunitet mundëson përjasje më praktike për vlerësimin e policimit në komunitet, mjaft projekte kanë marrë në analizë policimin në komunitet në Shqipëri në këndvështrime të ndryshme si vlerësimi i modelit PK në kulturën e policimit,^{xxxvii} perceptimi i kriminalitetit, rendit dhe sigurisë rrugore, vlerësimi i kapaciteteve të PSH për zbatimin e policimit në komunitet me fokus të rinjtë, si dhe një sërë studimesh që kanë të bëjnë me organizimin dhe operimin e forcave të policisë.

Me gjithë rëndësinë e PK si një nga politikat kryesore të PSH nuk është bërë asnjë vlerësim për bashkëpunimin mes PSH dhe një-ve deri më sot, edhe pse, siç përmendet më sipër,

Policia e Shtetit dhe IQV-të janë përgjegjëse për miratimin e strategjisë, siç parashikohet nga ligji.

Edhe pse ligji për policinë e shtetit të vitit 2007 dhe ligji për qeverisjen vendore lehtësojë procesin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes të PSH dhe IQV, hartimi dhe zbatimi i SVPQ në bashkëpunim me aktorët vendorë përballet me vështirësi të shumta.

Faktorët që pengojnë bashkëveprimin vijnë nga të dy palët, si nga PSH dhe nga IQV.

Problemet më të mëdha vijnë nga sfidat që kanë të bëjnë me transformimet organizative të Policisë së Shtetit të cilat nuk lehtësojnë procesin e bashkëpunimit. Strategjia e re kombëtare e policisë 2015-2021 trajton një pjesë të madhe të këtyre problemeve.

Së pari, probleme shfaqen si pasojë e nivelit të ulët të komunikimit dhe koordinimit brenda institucionit në nivel vendor^{xi}. Strukturat e policisë vazhdojnë të jenë vertikale dhe nuk kanë ndryshuar me zbatimin e policimin në komunitet duke vështirësuar komunikimin midis niveleve të vetë institucionit. Gjithashtu nuk ekziston një ndarje e qartë të detyrave brenda institucionit ku inspektorët e zonës kryejnë edhe detyra të tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me policimin në komunitet.^{xii,xlii} Së dyti, strukturat vendore vazhdojnë të jenë të ndërvarura dhe përgjegjëse ndaj institucioneve në nivel qendror,^{xliii} duke krijuar probleme me pavarësinë e funksionimit dhe menaxhimit në nivel vendor. Siç u diskutua më sipër, Prefekti është institucioni i pushtetit vendor ndaj të cilët policia ndihet më përgjegjëse dhe me të cilin bashkëpunon më së shumti edhe pse ky institucion vepron në nivel qendror për

qarkun. Gjithashtu, “Edhe pse ligji kërkon informimin dhe konsultimin e autoriteteve mbi tendencat e krimit dhe prioritetet policore, veprimet policore janë përgjegjësi e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Tiranë.”^{xliv} Organizimi i mëparshëm strukturor i policisë ku zbatimi i modelit organizativ të decentralizuar nga institucionet vendimmarrëse u kishte dhënë mëvetësi disa strukturave, duke krijuar burokraci të panevojshme në komunikim e drejtim, raporte të zhdrejta midis punës administrative dhe asaj operacionale etj., kishin dobësuar gradualisht strukturat dhe shërbimin në nivelin vendor e përgjithësisht performancën e Policisë.”^{xlv}

Së treti, policia është e ndjeshme ndaj ndryshimeve politike, një pasojë e drejtpërdrejtë e ndërvarësisë së policisë në nivel vendor, siç përshkruam më sipër, nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë. Ky problem theksohet edhe nga Strategjia Kombëtare e Policisë 2007-2013”.^{xlvi}

Së katërti, problem është edhe mungesa e trajnimeve të përshtatshme në nivel drejtimi dhe operativ. Në nivel drejtimi, policia nuk ka arritur ende të hartojë dhe vlerësojë SVPQ bazuar në filozofinë e policimit në komunitet dhe të sfidave kontekstuale që paraqesin komunitete të ndryshme.

Në të njëjtën kohë SVPQ raportojnë për një cilësi profesionale dhe etike të policisë të policisë.^{xlvii} Kjo e fundit mbështetet edhe nga drejtuesit e qeverisjes vendore, të cilët argumentojnë se oficerët e policisë të caktuar në terren në përgjithësi nuk kanë aftësitë e duhura të komunikimit për të afruar institucionet dhe madje edhe komunitetin. Kjo situatë është pjesërisht një pasojë e mungesës së trajnimit në fushën e policimit në komunitet,^{xlviii} dhe mungesës së trajnimit mbi etikën policore,^{xlix} në kurrikulën e shkollës bazë të policisë dhe

pjesërisht është problem i procesit të rekrutimit.ⁱ Në bazë të një studimi të kryer me forcat e policisë në territorin shqiptar, ekziston një nevojë për trajnime më të shpeshta dhe komplekse për policimin në komunitet.ⁱⁱ

Së pesti, infrastruktura e dobët e policisë dhe lëvizjet e shpeshta të punonjësve të policisë brenda dhe jashtë organizatës policore që çon në vështirësi në ndërtimin e besimit reciprok me komunitetin dhe institucionet e tjera si dhe në vetë operimin e policisë.ⁱⁱⁱ Këto pohime janë mbështetur edhe nga intervistat e kryera me oficerët e policisë edhe pse ata thonë se kjo prirje është më e pranishme në zonat urbane sesa ato rurale.ⁱⁱⁱⁱ Deri më 2014 rezultonte që rreth 46% e ndërtesave të policisë ishin të papërshtatshme e veç kësaj, ato nuk u përgjigjeshin nevojave për organizimin e ri që pritej të realizohej; 58% e mjeteve të motorike janë të amortizuara dhe shumë pak të përdorshme; rreth 46% e njësive të policimit janë pa numrin e nevojshëm të mjeteve të komunikimit e po kështu dhe uniforma e pajisjet e tjera janë plot defekte e mangësi dhe nuk u përgjigjen nevojave për një shërbim të rregullt policor.^{liv}

Së gjashti, IQV u mungon angazhimi dhe motivimi për të zgjidhur problemet e komunitetit në partneritet me policinë.^{lv} Ndërveprimi është nxitur kryesisht në anën e policisë, dhe IQV ende nuk kanë informacion të mjaftueshëm ose ende nuk kanë krijuar traditën për t'iu drejtuar policisë si dhe për t'i kërkuar llogari asaj.

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në kuadër të miratimit të Ligjit dhe Strategjisë së re Kombëtare të Policisë (2015-2021) dhe nëntë vite pas përpjekjeve të para për të adoptuar Policimin në Komunitet, ky studim sjell një vlerësim të kuadrit ligjor dhe strategjik mbi Policimin në Komunitet si dhe një vlerësim të zbatimit të tij në praktikë me qëllim dhënien e rekomandimeve për të lehtësuar procesin e zbatimit të instrumenteve në kontekstin institucional dhe social të vendit.

Policia e Shtetit ka zbatuar filozofinë e Policimit në Komunitet për nëntë vitet e fundit duke vendosur detyrime normative për hartimin e strategjive vjetore të policimit në komunitet dhe ndërtimit të partneritetit me institucionet e pushtetit vendor dhe aktorë të tjerë lokalë.

Në anën tjetër, policia ka ndërmarrë pak masa për të transformuar organizatën e policisë në të përshtatshme për të mirëpritur këtë filozofi si dhe për të ndërvepruar dhe bashkëpunuar me aktorët e tjerë. Strukturat ende vertikale dhe të centralizuara të policisë, trajnimet e pamjaftueshme në nivel drejtimi dhe operativ për policimin në komunitet si dhe lëvizjet e shpeshta të inspektorëve të policisë brenda dhe jashtë institucionit, nuk kanë bërë të mundur hartimin e strategjive vjetore si instrumente efikase të parandalimit.

Në fakt, SVPQ kanë probleme në lidhje me përputhshmërinë e tyre me ligjin ku më e rëndësishmja është dështimi në trajtimin e problemeve të komunitetit si dhe me formën dhe përmbajtjen e tyre, e cila është e njëjtë ndër vite dhe midis rajoneve duke

mos mundur dot t'i përshtaten kontekstit social, kulturor dhe mjedisor të zonës apo qarkut.

Pavarësisht se PSH dhe IQV kanë ndërvepruar në rrugë formale dhe jo-formale, ky ndërveprim nuk ka rezultuar në angazhimin e IQV në hartimin dhe zbatimin e SVPQ si dhe në krijimin e partneriteteve mes këtyre aktorëve duke vështirësuar punën e policisë në identifikimin e problemeve të komunitetit dhe në gjetjen e zgjidhjeve efikase.

Si pasojë, SVPQ nuk arritën të shërbenin si instrument “proaktiv” dhe lehtësues në ndërtimin e strukturave komunitare dhe zbatimi i tyre nuk mundësoi uljen e numrit të veprave penale siç parashikohej nga Strategjia Kombëtare e Policisë 2007-2013.

Në 2014/2015 u miratua ligji dhe strategjia e re e PSH e cila rivendos theksin në hartimin e SVPQ në bashkëpunim me aktorët vendorë. Në ndryshim nga strategjia e 2007-2013, strategjia e re parashikon ndryshime të thella për sa i përket strukturave dhe institucionit së policisë. Këto nisma erdhën si pasojë e një sërë studimesh të kryera rreth mungesës së efektivitetit dhe efikasitetit të mënyrës së vjetër të organizimit.

Nga ana tjetër, Strategjia 2015-2021 nuk parashikon asnjë instrument për të ndërtuar partneritetin me aktorët vendorë.

Përveç zbatimit formal të kërkesave ligjore, ky studim rekomandon një qasje me proaktive të Policisë së Shtetit për të forcuar institucionalizimin e marrëdhënieve me aktorët vendorë.

Për të zhvilluar praktiken e komunikimit dhe ndërveprimin ndërmjet Policisë së Shtetit dhe institucioneve vendore nevojitet organizimi i konsultimeve periodike me aktorët

institucionalë vendorë. Nisma për këtë mund të vijë si nga lart-poshtë, përmes udhëzimit apo urdhrit të Drejtorit të Policisë, ashtu si kundër mund të jetë një proces dinamik ku drejtues të ndryshëm të Policisë së Shtetit në nivel qarku mund të nxisin individualisht dhe institucionalisht krijimin e modeleve të llogaridhënies publike.

Policia e Shtetit duhet t'u paraqesë çdo fundviti këshillave bashkiakë raportin e zbatimit të strategjisë vjetore të sigurisë dhe të prezantojë projekt-strategjinë për vitin në vijim. Në raportim të jenë të ftuar edhe aktorë të tjerë vendorë.

7. REFERENCAT

- A.C.Germann (1969), "Community Policing:An assessment", Journal of Criminal Law and Criminology, Volume 60, Issue 1
- Koci, T. Gjuraj (2016) "The relationship between community policing and human rights in Albania's police reform", The international Journal of Human Rights
- B.R.Ferreira, (1996) "The use and effectiveness of community policing in a democracy", Policing in Central and Eastern Europe: Comparing Firsthand Knowledge with Experience from the West, College of Police and Security Studies, Slovenia
- Bureau of Justice Assistance (1994) "Understanding Community Policing: A framework for action"
- C.Call, M.Barnett (1999), "Looking for a few good cops" , International Peacekeeping 6(4)
- D.Kahan (2002),"Reciprocity, Collective Action, and Community Policing",California Law Review, V. 90, Issue 5
- G. L. Kelling, J.Q. Wilson (1982), "Broken Windows"
- ICITAP "Për kushtet e punës së punonjësve të policisë në terren"
- L.Denney (2015) , "Securing Communities? :Redefining Community Policing to achieve Results", Overseas Development Institute
- McConville and Shepherd, Watching Police, Watching Communities; and Waddington, Policing Citizens, 213
- M.Brogden, P.Nijhar (2013), "Community Policing: National and international models and approaches", Routledge
- M.Rowe(2008), "Introduction to Policing", Sage Publications
- P.A.J Waddington(1999) "Policing Citizens:Authority and Right", Psychology Press, pg. 209
- SIPU, Swedish Support to MoI/PSH on Community Policing Programme, "Study Report, Capacities and effectiveness of the PSH Community Policing programme: Developing effective working partnerships with local government, central government,

NGOs and communities and with a particular emphasis on youth partnerships.” Tirana, 2012.

- SACP, “Studim mbi Matjen e Sigurisë në Komunitet”, Instituti për Ndryshim dhe Liderhip dhe Qendra e Biznesit Teknologjisë dhe Drejtimit, Nëntor 2013
- SACP, “Policia, Rendi, Siguria dhe Marrëdhëniet me Komunitetin: Gjetje dhe rekomandime për politika që përmirësojnë punën e Policisë së Shtetit Shqiptar në lidhje me policimin në komunitet” Mbështetja Suedeze për MB/PSH për Policimin në Komunitet, prill 2014
- Skogan dhe Hartnett, (1997)
- V.E.Kappeler, L.K.Gaines (2011) “Community Policing: A Contemporary Perspective”, 6th Edt.
- U.S Department of Justice (2014), “Community Policing Defined”, COPS

Ligje dhe Strategji

- Ligji 9749/2007 “Për Policinë e Shtetit”
- Ligji 8927/2002 “Për prefektin”
- Ligji 8652/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”
- Ligji 9559/2006 , “Për një shtesë në Ligjin 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”;
- Ligji 8756/2001 “Për emergjencat civile” (nenet 17,18)
- Ligji 9296/2004 “Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore” (Nenet 12 dhe 14)
- Ligji 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”
- VKM Nr. 8/2002 “Për ngritjen e Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore dhe Drogës”
- Ligji 9559/2006 , “Për një shtesë në Ligjin 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”;
- VKM Nr. 8/2002 “Për ngritjen e Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore dhe Drogës, Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, Komiteti Ndërministror i Sigurisë Rrugore ”

- Strategjia Kombëtare e Policisë së Shtetit 2007-2013
- Strategjitë Vjetore të Policimit në Qark 2007-2014 për të 12 qarqet e Shqipërisë
- Strategjia e trajnimit të Policisë 2012-2016
- Strategjia Kombëtare e Policisë së Shtetit 2015-2021

-
- ⁱ Strategjia Kombëtare e Policisë së Shtetit 2007-2013
- ⁱⁱ Neni 122 i Ligjit për PSH (2007) thotë:
- ⁱⁱⁱ Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013, f. 12
- ^{iv} Duke qenë se strategjia e re kombëtare e policisë u miratua në vitin 2015, kemi marrë në analizë edhe SVPQ për vitin 2014.
- ^v Duke qenë se ligji përcakton konsultimin e Policisë së Shtetit me IQV, gjetja e shembujve të bashkëpunimit të mirë jo vetëm do të kontribuojë në zbatimin e modelit PK, por në të njëjtën kohë është një tjetër tregues nëse strategjitë janë të rregullta dhe në përputhje me ligjin. (A).
- ^{vi} Shiko tek Metodologjia
- ^{vii} Duke qenë se strategjia e re policisë ka nisur aplikimin e saj në 2015, SVPQ e vitit 2014 është përfshirë gjithashtu në këtë analizë.
- ^{viii} Duke qenë se strategjia e re kombëtare e policisë u miratua në vitin 2015, ne kemi marrë në analizë edhe SVPQ për vitin 2014.
- ^{ix} Rowe, Introduction to Policing, f. 74
- ^x Denney (2015)
- ^{xi} C.Call, M.Barnett (1999), "Looking for a few good cops", International Peacekeeping 6(4)
- ^{xii} Ibid
- ^{xiii} M.Brogden, P.Nijhar (2013), "Community Policing: National and international models and approaches", Routledge
- ^{xiv} Skogan dhe Hartnett, (1997)
- ^{xv} McConville and Shepherd, Watching Police, Watching Communities; and Waddington, Policing Citizens, 213
- ^{xvi} Waddington, Policing Citizens, 209
- ^{xvii} Ligji 9749/2007 "Për Policinë e Shtetit" neni 122
- ^{xviii} Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013, f. 10
- ^{xix} Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013, f. 10
- ^{xx} Shënim: shih partneritetin me komunitetin në faqen tjetër.
- ^{xxi} A. Koci, T. Gjuraj (2016) "Marrëdhëniet mes policimit dhe të drejtave të njeriut në reformën e policisë në Shqipëri"
- ^{xxii} Strategjia e Policisë së Shtetit 2015-2021
- ^{xxiii} Strategjia Kombëtare e Policisë së Shtetit 2015-2021
- ^{xxiv} Po aty.
- ^{xxv} Në mungesë të një studimi
- ^{xxvi} Bazuar mbi një studim të ndërmarrë nga PSH dhe ICITAP "Për kushtet e punës së punonjësve të policisë në terren"
- ^{xxvii} Letër zyrtare, Drejtoria e Policisë së Shtetit, 20 prill 2015
- ^{xxviii} Ligji 9559/2006, "Për një shtesë në Ligjin 7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope"; VKM Nr. 8/2002 "Për ngritjen e Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore dhe Drogës"
- ^{xxix} Elementët që përputhen kanë të bëjnë me detyrimet e Policisë së Shtetit të përcaktuara me ligj, siç e kemi përmendur më lart.
- ^{xxx} Shembull: Strategjia e Elbasanit të 2009 flet për plan masash ndaj sezonit turistik veror dhe mbipopullimit të plazheve.
- ^{xxxi} Strategjia Kombëtare e Policisë 2007-2013
- ^{xxxii} Strategjia Kombëtare e Policisë 2007, fq.16

-
- ^{xxxiii} SVPQ 2013 janë përjashtuar duke qenë se disa prej tyre nuk janë mundësuar.
- ^{xxxiv} Mbështetur në Strategjinë e Qarkut Kukës (2010)
- ^{xxxv} Intervistë telefonike më 3 kryetarë bashkie.
- ^{xxxvi} A. Koci, T. Gjuraj (2016) “ The relationship between community policing and human rights in Albanian’s police reform”
- ^{xxxvii} Programi SACP, “*Policia, Rendi, Siguria dhe Marrëdhëniet me Komunitetin: Gjetje dhe rekomandime për politika që përmirësojnë punën e Policisë së Shtetit Shqiptar në lidhje me policimin në komunitet*” Mbështetja Suedeze për MB/PSH për Policimin në Komunitet, prill 2014
- ^{xxxviii} Programi SACP, “Studim mbi Matjen e Sigurisë në Komunitet”, Instituti për Ndryshim dhe Liderhip dhe Qendra e Biznesit Teknologjisë dhe Drejtimit, Nëntor 2013
- ^{xxxix} SIPU, Swedish Support to Mol/PSH on Community Policing Programme, “*Study Report, Capacities and effectiveness of the PSH Community Policing programme: Developing effective working partnerships with local government, central government, NGOs and communities and with a particular emphasis on youth partnerships.*” Tirana, 2012.
<http://www.cp-project.al/wp-content/uploads/2013/01/Baseline-study-report-on-PSH-partnerships-and-youth.pdf>
- ^{xi} Strategjia Gjirokastrë (2009, 2010)
- ^{xii} Intervista: POL01, POL02, POL03
- ^{xiii} Shënim: Strategjia e Policisë nuk parashikon krijimin e strukturave të tilla.
- ^{xiii} Po aty.
- ^{xiv} A. Koci, T. Gjuraj (2016) “ The relationship between community policing and human rights in Albanian’s police reform”
- ^{xiv} Strategjia e Policisë së Shtetit 2015-2021
- ^{xvi} A. Koci, T. Gjuraj (2016) “ The relationship between community policing and human rights in Albanian’s police reform”
- ^{xvii} Strategjia Kukës (2010,2011)
- ^{xviii} Shënim: shiko tek seksioni ‘Adresimi i problemeve të komunitetit’
- ^{xix} Shënim: Trainimi mbi etikën përmban 5 orë nga totali prej 200 orë të kursit të trainimit bazë.
- ⁱ Intervistë: POL03
- ⁱⁱ Sida Report on Community Policing 2012, pg.36
- ⁱⁱⁱ Intervista telefonike, 30/40 përfaqësues të pushtetit vendor
- ⁱⁱⁱ Intervistë POL01, POL02, POL03
- ^{liv} Strategjia e Kombëtare Policisë së Shtetit 2015-2021
- ^{lv} Strategjia e Qarkut Kukës (2012)